

Pasqyrat Financiare

ILLYRIAN GUARD SH.A

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Përmbajtje

	Faqe
Raporti i Audituesit te Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Performancës dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	4
Pasqyra e Flukseve Monetare	5
Shënimet për Pasqyrat Financiare	5-15

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e Illyrian Guard Sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Illyrian Guard Sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Bazat e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë..

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2021

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020 Lekë	31 dhjetor 2019 Lekë
Aktive			
Aktivët afatshkurtra			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4	166,129,955	249,367,312
Llogari të arkëtueshme	5	137,749,120	40,087,112
Shpenzime të shtyra (veshje)	6	48,819,903	665,909
Tatim fitimi i parapaguar		1,623,756	-
Tatim fitimi i shtyrë	7	357,965	200,178
Aktive të tjera		30,939	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		354,711,638	290,320,511
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata material	8	63,457,466	37,792,240
Aktive afatgjata jo material	8.1	729,293	1,210,290
Totali i Aktiveve afatgjata		64,186,759	39,002,530
Totali i Aktiveve		418,898,397	329,323,041
Detyrimet dhe Kapitali			
Detyrimët afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	9	1,121,161	5,447,211
Tatimi mbi fitimin		-	1,647,683
Llogari të tjera të pagueshme	10	137,747,546	48,458,879
Hua afatshkurtër	11	24,589,793	4,428,295
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		163,458,500	59,982,067
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjatë	11	229,242,721	251,420,538
Totali i Detyrimeve afatgjata		229,242,721	251,420,538
Totali i Detyrimeve		392,701,221	311,402,605
Kapitali			
Kapitali i paguar	12	10,000,000	10,000,000
Rezervat ligjore		396,022	-
Fitimi i pashpërndarë		7,524,414	-
Fitim/(Humbja) e vitit financiar		8,276,741	7,920,436
Totali i Kapitalit		26,197,177	17,920,436
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		418,898,398	329,323,042

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi më 31 mars 2021 dhe firmosur për llogari të tij nga:

Administrator

Përgatitur nga:

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirës

	Shënime	Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019
		Lekë	Lekë
Të ardhurat			
Të ardhura nga shitja e shërbimeve të sigurisë me roje		848,827,865	93,008,730
Të ardhura nga shitje e shërbimeve të sigurisë me sistem		179,139,773	21,260,550
Total i të ardhurave	13	1,027,967,638	114,269,280
Minus: Shpenzimet Operative			
Përfitimet e punonjësve	15	(930,023,761)	(93,882,309)
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(13,267,635)	(2,082,579)
Shpenzimet administrative dhe të tjera	16	(63,932,398)	(7,196,864)
Fitim (Humbje) nga operacionet		20,743,844	11,107,529
Të ardhura (shpenzime)financiare, neto	14	(10,780,577)	(1,739,587)
Total të ardhura (shpenzime) financiare, neto		(10,780,577)	(1,739,587)
Fitim para tatimit		9,963,267	9,367,942
Tatim fitimi		(1,686,526)	(1,447,505)
Fitimi neto për vitin		8,276,741	7,920,436
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		8,276,741	7,920,436

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali	Rezerva ligjore	Fitim i pashpërndarë	Fitimi i vitit	Totali
	Lekë	Lekë		Lekë	Lekë
Më 1 janar 2019	-	-	-	-	-
Kapitali aksionar	10,000,000	-	-	-	10,000,000
Rezervë ligjore	-	-	-	-	-
Fitimi i pashpërndarë	-	-	-	-	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	-	7,920,436	7,920,436
Më 31 dhjetor 2019	10,000,000	-	-	7,920,436	17,920,436
Më 1 janar 2020	10,000,000	-	-	7,920,436	17,920,436
Kapitali aksionar	-	-	-	-	-
Rezervë ligjore	-	396,022	-	(396,022)	-
Fitimi i pashpërndarë	-	-	7,524,414	(7,524,414)	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	-	8,276,741	8,276,741
Më 31 dhjetor 2020	10,000,000	396,022	7,524,414	8,276,742	26,197,177

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve Monetare

Shënime	Për vitin e mbyllur në	Për vitin e mbyllur në
	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	Lekë	Lekë
Fitimi neto (humbja para tatim fitimit)	9,963,267	9,367,942
Rregullime per:		
Zhvlërësim të aktiveve afatgjata materiale	13,267,635	2,082,579
Shpenzime interesi	10,780,577	1,739,587
Fitimi (humbja) operative para ndryshimeve në kapitalin punues	34,011,479	13,190,108
Ulje / (ritje) në llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera të arkëtueshme	(145,846,940)	(40,753,022)
(Ulje) /ritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	84,962,618	53,906,089
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ	(26,872,843)	26,343,175
Interes i paguar	(10,841,324)	(890,754)
Taksa të paguara	(5,115,752)	-
Flukset neto të mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(42,829,920)	25,452,421
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e investimit		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(38,451,864)	(41,085,109)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Mjete monetare neto (te perdorura) ne aktivitetet investuese	(38,451,864)	(41,085,109)
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese	(1,957,128)	255,000,000
Kapitali aksioner	-	10,000,000
Mjete monetare neto (te perdorura) ne aktivitetet financuese	(1,957,128)	265,000,000
Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	(83,238,911)	249,367,312
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 1 janar	4	-
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor	4	249,367,312

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria 'Illyrian Guard' sh.a, u themelua në 12 prill 2019 si person juridik shqiptar në formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, për të ushtruar veprimtarinë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, teknologjisë së informacionit, zhvillimit, prodhimit, mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve teknologjike të monitorimit të rendit dhe sigurisë publike. Shoqëria kryen aktivitetet me qëllim ofrimin e shërbimit me kushte më të mira dhe kosto më të favorshme se tregu. Shoqëria kryen aktivitetet e tjera tregtare me qëllim gjenerimin e fitimeve.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe nga statuti i saj.

Shoqëria në 31 dhjetor 2020 ka të punësuar 1604 punonjës (2019- 551 punonjës).

Shoqëria e ushtron veprimtarinë në Tiranë dhe është rregjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore në Tiranë. Adresa e Shoqërisë është pranë Akademisë së Sigurisë, Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë, 1016, Republika e Shqipërisë.

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Ministria e Brendshme, me adresë në "Sheshi Skënderbej", nr.3, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm.

Kapitali i shoqërisë është 100% shtetëror.

Administratori i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 ishte Selim Troci. Me 25 janar 2021, administrator i Shoqërisë është emëruar Drini Nikolla. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë dy vjeçare. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë: z. Julian Hodaj, Znj. Elena Pici, Znj. Lorena Pullumbi.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori më 31 mars 2021.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjit nr. 25/2018, datë 10 maj.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Këto pasqyra financiare janë shprehur në lekë, që është monedha raportuese e shoqërisë.

2.1 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjve gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në

shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Gjatë fillimit të vitit 2020, u përhap pandemia COVID-19, ku në Shqipëri impaktin masiv e pati në muajin mars 2020, kur u morën masa drastike për parandalimin e përhapjes duke mbyllur shumë prej aktiviteteve.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që pandemia COVID-19 do të impaktojë negativisht në periudhat e mëpasshme të ushtrimit të aktivitetit. Drejtimi i Shoqërisë nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim paraprak të këtij impakti.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën amortizimit linear, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë si më poshtë:

Aktive afatgjata materiale	%
Përmirësime dhe rikonstruksione në ndërtesa	10
Makineri dhe pajisje	20
Mjete transporti	20
Intalime teknike	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20

Kompjutera dhe pajisje IT	25
Armatime	5

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

3.2 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivitet. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivitet.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë si më poshtë:

Aktive afatgjata jo materiale	%
Programe kompjuterike	25

3.3 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.4 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.5 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arke në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

3.6 Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikembehën në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Kursi zyrtar i këmbimit për Euro dhe USD në Lekë, në fund të vitit, paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 Euro	123,7	121,77
1 USD	100,84	108,64

Shoqëria nuk ka veprime në monedhë të huaj, prandaj nuk ka diferenca nga kurset e këmbimit

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në ligjin në fuqi për "Tatimin mbi fitimin". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin të gjithë barrën për vitin korrent. Tatimi mbi fitimin llogaritet si 15 % e të ardhurave të tatueshme si është përcaktuar në SKK dhe legjislacionin Shqiptar.

3.9 Detyrimet e pas daljes në pension dhe planet e pensioneve

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

3.10 Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur duke u mbështetur në parimin e vijmësisë.

4 Mjetet monetare

Mjetet monetare përbëhen nga paraja dhe ekuivalentet e saj dhe janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020 Lekë	31 dhjetor 2019 Lekë
Mjete monetare në arkë	-	-
Llogari rrjedhëse në bankë		
-në monedhë vendase	166,129,955	249,367,312
-në monedhë të huaj	-	-
TOTALI	166,129,955	249,367,312

Vlera e kredisë së papërdorur deri në fund të vitit 2020 është 87 394 001 Lekë.

5 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim:

	31 dhjetor 2020 Lekë	31 dhjetor 2019 Lekë
Llogari të arkëtueshme nga klientët	137,749,120	40,087,112
Totali	137,749,120	40,087,112

6 Parapagime dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime për lënde djegëse	488,322	646,757
Parapagime per veshje	43,353,872	-
Te ardhura te pafaturuara	4,864,097	-
Shpenzime të tjera të shtyra	113,662	19,152
Totali	48,819,903	665,909

7 Tatim fitimi i shtyrë

Llogaritja për tatimin mbi fitimin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Diferencë e përkohëshme nga amortizimi	1,111,106	484,130
Shpenzim i përlogaritur për interesa	(59,191)	850,389
Tax 15%	15%	15%
Tatim i shtyrë për vitin	157,787	200,411
E drejtë për tatimin e shtyrë	358,198	200,411

8 Aktivet Afatgjata

8.1 Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si vijon:

	Mjete Transporti	Orendi dhe pajisje zyre	Kompjutera dhe pajisje informatike	Instalime teknike	Makineri dhe pajise pune	Pajisje të tjera	Përmiresime në ndertesa	Totali
Kosto								
Me 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtesat	11,683,000	2,772,920	6,134,501	14,771,197	775,000	2,850,000	731,991	39,718,149
Pakesime								
Me 31 dhjetor 2019	11,683,000	2,772,920	6,134,501	14,771,197	775,000	2,850,000	731,991	39,718,149
Amortizimi								
Më 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	579,883	120,399	335,066	770,575	56,284	40,110	24,052	1,926,369
Më 31 dhjetor 2019	579,883	120,399	335,066	770,575	56,284	40,110	24,052	1,926,369
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2019	11,103,117	2,652,521	5,799,435	14,000,622	718,716	2,809,890	707,939	37,792,240

Illyrian Guard sh.a

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Mjete Transporti	Orendi dhe pajisje zyre	Kompjutera dhe pajisje informatike	Instalime teknike	Makineri dhe pajise pune	Pajisje të tjera	Përmiresime në ndërtesa	Pajisje speciale dhe armatime me	Totali
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2019	11,103,117	2,652,521	5,799,435	14,000,622	718,716	2,809,890	707,939	-	37,792,240
Kosto									
Me 1 janar 2020	11,683,000	2,772,920	6,134,501	14,771,197	775,000	2,850,000	731,991	-	39,718,609
Shtesat	-	180,000	4,161,529	6,496,946	9,012,632	41,800	26,667	18,528,000	38,447,574
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2020	11,683,000	2,952,920	10,296,030	21,268,143	9,787,632	2,891,800	758,658	18,528,000	78,166,183
Amortizimi									
Më 1 janar 2020	579,883	120,399	335,066	770,575	56,284	40,110	24,052	-	1,926,369
Shtesa	2,335,320	554,280	2,228,676	4,027,052	1,620,977	496,567	147,331	1,466,091	12,876,295
Më 31 dhjetor 2020	2,915,203	674,679	2,563,742	4,092,880	1,677,261	536,677	171,383	1,466,091	12,942,213
Vlera kontabël neto 1 janar 2020	11,103,117	2,652,521	5,799,435	14,000,622	718,716	2,809,890	707,939	-	37,792,240
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2020	8,767,797	2,278,241	7,732,288	16,404,688	8,110,371	2,355,123	587,275	17,061,909	63,297,606

Shoqëria, me Akt-dorëzimin nr 3918 date 28 qershor 2020, bazuar në Urdhërin nr 434 datë 10 qershor 2020 të Ministrit të Brendshëm ka marrë në përdorim të përkohshëm nga Ministria e Brendshme pa shpërblim dhe pa afat të caktuar, të një pjese të pronës, ndërtesë me emërtimin “Komanda e PU-së”, ndërtim i vitit 1972 me sipërfaqe 326 m² dhe vlerë të mbetur 8,649,769 Lekë. Me Akt-dorëzimin nr. 217 datë 18 shtator 2020, bazuar në Urdhërin nr. 281 datë 31 gusht 2020 të Ministrit të Brendshëm i është shtuar këtij përdorimi dhe një pjesë e pronës nr. 180, me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti ushtarak 6620)”, ndërtim i vitit 1972 me sipërfaqe 31,641.4 m² dhe vlerë të mbetur 1,269,307,604 Lekë. Ndërtesa nuk përmbush kushtet për njohje të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat e shoqërisë dhe si rrjedhim shoqëria e mban dhe i regjistron në regjistrat e saj jashtë bilancit.

8.2 Aktivet Afatgjata Jo-materiale

Aktivitet Afatgjata Jo-materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si vijon:

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Me 1 janar 2019	-	-
Shtesat	1,366,500	1,366,500
Me 31 dhjetor 2019	1,366,500	1,366,500
Amortizimi		
Më 1 janar 2019		
Amortizimi i vitit	156,210	156,210
Më 31 dhjetor 2019	156,210	156,210
Vlera kontabël neto 1 janar 2019	-	-
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2019	1,210,290	1,210,290

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Me 1 janar 2020	1,210,290	1,210,290
Shtesat	-	-
Pakesime	-	-
Me 31 dhjetor 2020	-	-
Amortizimi		
Më 1 janar 2020	156,210	156,210
Amortizimi i vitit	324,787	324,787
Më 31 dhjetor 2020	480,997	480,997
Vlera kontabël neto 1 janar 2020	1,054,080	1,054,080
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2020	729,293	729,293

9 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Të pagueshme ndaj furnitorëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë vendas në Lekë	1,121,161	5,447,211
Totali	1,121,161	5,447,211

10 Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme lidhen me arkëtimet e marra në avancë dhe detyrimet tatimore, të cilat janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga	80,551,081	25,237,426
Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	26,974,123	5,778,106
Paga të pagueshme	6,396,360	4,450,924
Tatim në burim	82,821	163,346
TVSH e pagueshme	23,679,881	12,829,077
Të tjera	63,280	-
Total	137,747,546	48,458,879

11 Huamarrje

Shoqëria me kontratën bankare datë 1 nëntor 2019 ka marrë hua pranë bankës Intesa San Paolo, në vlerën 255,000,000 Lekë, me normë interesi 4.25% dhe afat për 10 vite. Përdorimi fondeve të huasë është i kushtëzuar me qëllim blerjen e pajisjeve të nevojshme për veprimtarinë, vetëm për investimdhjetor e. Në bazë të kushteve të kontratës, gjatë vitit të parë shoqëria nuk shlyen principal, por vetëm interesa. Huamarrja në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pjesa afatshkurtër:		
Interes i përlogaritur	789,642	3,579,462
Hua bankare	23,800,151	848,833
Pjesa afatgjatë:		
Hua bankare	229,242,721	251,420,538
Tatim fitimi i pagueshëm	253,832,514	255,848,833

12 Kapitali aksionar

Illyrian Guard sh.a është Shoqëri aksionere me kapital themeltar 10,000,000 Lekë. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar është 100% shtetëror dhe zotërohet nga Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm.

13 Të ardhurat

Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	2020	2019
Të ardhura nga shërbimet e sigurisë me roje	848,827,865	93,008,730
Të ardhura nga shërbimet e sigurisë me sistem	179,139,773	21,260,550
Të ardhura të tjera	-	-
Totali	1,027,967,638	114,269,280

Të ardhurat/shpenzimet financiare neto

	2020	2019
Shpenzime interesi hua bankare	10,780,577	1,739,587
Totali	10,780,577	1,739,587

14 Kosto e punës

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	2020	2019
Paga	797,337,977	80,406,760
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	132,624,236	13,414,837
Sigurim jete	61,548	60,712
Totali	930,023,761	93,882,309

15 Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera analizuar si më poshtë:

	2020	2019
Shpenzime për veshje pune	30,788,628	1,408,320
Qira për makina	14,431,000	1,009,000
Qira	4,899,847	446,858
Shpenzime për karburant	3,107,987	573,293
Shpenzime Interneti	2,444,363	108,776
Kancelari e shtypshkrime	1,875,700	692,475
Të tjera administrative	1,650,208	402,410
Pagesa për ndermjetes, honorare	1,375,962	931,917
Energji elektrike	852,301	185,844
Mirembajtje e riparime	703,456	332,882
Transferime, udhëtim, diëta	447,263	96,140
Shpenzime për siguracion kollaodim mjeteesh	390,000	653,773
Shpenzime telefon	367,503	78,119
Ujë	208,315	47,100
Gjoha dhe demshperblime	160,432	40,151
Sherbime bankare	148,447	48,839
Taksa dhe tarifa vendore	78,905	50,550
Shpenzime noteriale	2,080	75,418
Shpenzime administrative të tjera	-	15,000
Totali	63,932,398	7,196,864

16 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019-15%). Në vitin 2020 Shoqëria ka rezultuar me një fitim/ (humbje) kontabël dhe fiskal si më poshtë:

	2020	2019
	Lekë	Lekë
1 Fitimi/(humbje) para tatimit	9,963,267	9,367,942
2 Shpenzime të pazbritshme:	2,332,154	1,616,614
3 Fitimi/(humbje) fiskal (1+2)	12,295,421	10,984,555
4 Fitim/(humbje) akumuluar	12,295,421	-
5 Norma e tatim fitimit	15%	15%
6 Tatim fitimi vitit fiskal	1,844,313	1,647,683
7 Tatim fitimi i shtyrë	157,787	200,178
8 Tatim fitimi vitit (6-7)	1,686,526	1 447,505

Shpenzimet e pazbritshme

Shpenzime te pazbritshme (të listuara si më poshtë):	2020	2019
Amortizim AAM dhe AJM	1,111,106	484,130
Energji elektrike	852,301	185,844
Uje	208,315	47,100
Transferime, udhetim, dieta	-	9,000
Gjoha dhe demshpërblime	160,432	40,151
Shpenzime interesi të përlogaritura	-	850,389
Totali	2,332,154	1,616,614

20. Angazhime dhe pasiguri

Çështje ligjore

Gjate aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, shoqëria nuk do të ketë ngjarje mepeshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

18. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet në pasqyrat financiare